



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1084/10 prot.,

Datë 14.05.2025

V E N D I M
Nr. 652/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 619/2025, datë 06.05.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-42242-03-24-2025, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”, me fond limit 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025 na autoriteti kontrktor , Bashkia Patos.
- Ankimues:** “MURATI” SHPK me Nipt J66702413V dhe adresë Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos
Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 06.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 619/2025, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MURATI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-42242-03-24-2025, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”, me fond limit 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025 na autoriteti kontrktor , Bashkia Patos
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “MURATI” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “MURATI” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Me shkresën nr. 1272/10 prot., datë 09.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1084/7 prot., datë 12.05.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Patos, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 619/2025 datë 06.05.2025 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të ofertave dhe njoftimin drejtuar operatorit ekonomik për dorëzim dokumentacioni si operator ekonomik i renditur i pari mbështetur në nenin 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1272/10 prot., datë 09.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1084/7 prot., datë 12.05.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Patos, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 619/2025 datë 06.05.2025 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të ofertave dhe njoftimin drejtuar operatorit ekonomik për dorëzim dokumentacioni si operator ekonomik i renditur i pari mbështetur në nenin 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomikë “MURATI” SHPK në përputhje me vendimin e KPP Nr. 619/2025, datë 06.05.2025

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-42242-03-24-2025, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”, me fond limit 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025 na autoriteti kontraktor , Bashkia Patos.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

